



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 4.3.2025

Nr: 238

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “PARTIA
DEMOKRATIKE-ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE”, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 4.3.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1547 prot., datë 3.3.2025, me:

- KËRKUES:** Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, me Kryetar Z. Sali Berisha
OBJEKTI: Regjistrimi i koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
BAZA LIGJORE: Neni 65, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Sali Berisha, brenda afatit të ligjor të përcaktuar ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 1547 prot., datë 3.3.2025, për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.

Data: 4.3.2025 Nr: 238
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” me shkronja nistore “PD-ASHM” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” është depozituar marrëveshja e nënshkruar nga kryetarët e partive politike pjesëmarrëse në këtë koalicion, të cilat do të jenë: 1. “Partia Demokratike”, 2. “Partia e Lirisë”, 3. “Partia Republikane Shqiptare”, 4. “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, 5. “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, 6. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, 7. “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, 8. “Partia Emigracioni Shqiptar”, 9. Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, 10. Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, 11. Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, 12. “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, 13. “Partia Lëvizja e Legalitetit”, 14. “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, 15. “Partia Ora e Shqipërisë”, 16. Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, 17. “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë”, 18. Partia “Fryma e Re Demokratike”, 19. Partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, 20. Partia Balli Kombëtar” 21. Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, 22. “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, 23. “Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, 24. Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare”, 25. Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, 26. Partia “Drejtimi Integrim dhe Unitet”.

Marrëveshja përmban:

1. Shprehjen e vullnetit të 26 (njëzetë e gjashtë) partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare të koalicionit;
2. Formimin e koalicionit me emrin “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”;
3. Shkronjat nistore të koalicionit “ PD-ASHM”;
4. Siglën e koalicionit;
5. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Partia Demokratike”.
6. Autorizimin e Z. Sali Berisha, kryetar i partisë “Partia Demokratike”/ose të autorizuarin prej tij, të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listat shumëmbrore dhe çdo dokumentacion të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit
7. Autorizimin e z. Franci Nuri dhe/ose z. Marash Logu, i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV;
8. Autorizimin e z. Franci Nuri, dhe/ose z. Marash Logu, i cili do të ketë të drejtën të përfaqësojë koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit;
9. Autorizimin e z. Franci Nuri, dhe / ose z. Marash Logu, i cili do të ketë të drejtën të paraqesë kërkesën për regjistrimin e koalicionit në KQZ, si dhe cdo dokumentacion tjetër të nevojshëm, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton rrethin e subjekteve që mund të regjistrohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si koalicion zgjedhor:

- a) Kushti i parë ligjor është që koalicioni mund të formohet nga parti politike.
- b) Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ketë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e koalicionit.

- c) Kushti i tretë është që numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion duhet të jetë dy ose më shumë se dy.

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar rezulton se, kërkesa për t'u regjistruar si koalicion, është e bazuar për partitë pjesë e koalicionit si më poshtë:

1. “Partia Demokratike”, me kryetar z. Sali Berisha, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 145 datë 24.2.2025.
2. “Partia e Lirisë”, me kryetar z. Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 152 datë 24.2.2025.
3. “Partia Republikane Shqiptare”, me kryetar z. Fatmir Mediu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin, nr. 186 datë 25.2.2025.
4. “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 153 datë 24.2.2025.
5. “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar z. Vangjel Dule, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin, nr. 162 datë 25.2.2025.
6. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, me kryetar z. Agron Duka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 169 datë 25.2.2025.
7. “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me kryetar z. Kujtim Gjuzi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 143 datë 24.2.2025.
8. “Partia Emigracioni Shqiptar”, me kryetar z. Kostaq Papa, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 173 datë 25.2.2025.
9. Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me kryetar z. Gjet Ndoj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 209 datë 26.2.2025.
10. Partia “Aleanca Europiane Ekologjike”, me kryetar z. Sazan Guri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 225 datë 28.2.2025.
11. Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar”, me kryetar z. Gjovalin Shqalshi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 180 datë 25.2.2025.
12. “Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, me kryetar z. Nikolin Staka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 175 datë 25.2.2025.
13. “Partia Lëvizja e Legalitetit”, me kryetar z. Shëptim Axhani, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 155 datë 24.2.2025.
14. “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 149 datë 24.2.2025.
15. “Partia Ora e Shqipërisë”, me kryetar z. Zef Shtjefni, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin, nr. 172 datë 25.2.2025.
16. Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare”, me kryetar z. Mhill Gecaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 166, datë 25.2.2025.
17. “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë”, me kryetar z. Dhimitër Muslia, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 156 datë 24.2.2025.
18. Partia “Fryma e Re Demokratike”, me kryetar z. Sali Shehu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 178 datë 25. 2.2025.
19. Partia “Bashkimi Liberal Demokrat”, me kryetar z. Arian Starova, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 176 datë 25.2.2025.



20. “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 150 datë 24.2.2025.
21. Partia “Balli Kombëtar Demokrat”, me kryetar z. Artur Roshi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 148 datë 24.02.2025.
22. “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, me kryetar z. Selami Jenishehri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 205 datë 26.2.2025.
23. “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë”, me kryetar z. Rivelino Çuno, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 207 datë 26.2.2025.
24. Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare”, me kryetar z. Muharrem Doda, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 184 datë 25.2.2025.
25. Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, me kryetar z. Vasil Sterjovski, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 163 datë 25.2.2025.
26. Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet”, me kryetar z. Shpëtim Idrizi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, me vendimin nr. 167 datë 25.2.2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi bëri verifikimet përkatëse, konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 26 (njëzet e gjashtë) partitë e sipërcituara është në përputhje me nenet 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenet 64, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Regjistrimin e Koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, përfaqësuar nga Z. Sali Berisha, me shkronja nistore “PD-ASHM”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025, e përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:
 1. “Partia Demokratike” (PD).
 2. “Partia e Lirisë” (PL).
 3. “Partia Republikane Shqiptare” (PR)
 4. ” Partia Demokristiane e Shqipërisë” (PDK)
 5. “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ)
 6. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” (PAA)
 7. “Partia Kombëtare Konservatore Albania” (PKKA)
 8. “Partia Emigracioni Shqiptar” (PESH)
 9. Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare” (AAK)
 10. Partia “Aleanca Europiane Ekologjike” (AEE)
 11. Partia “Personat me Aftësi të Kufizuar” ((PPAK)
 12. “Partia Lëvizja Demokratike Për Ndryshim” (PLDN)
 13. “Partia Lëvizja e Legalitetit” (PLL)
 14. “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” (PBD)

15. “Partia Ora e Shqipërisë” (POSH)
 16. Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare” (LDK)
 17. “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë” (PKD)
 18. Partia “Fryma e Re Demokratike” (FRD)
 19. Partia “Bashkimi Liberal Demokrat” (BLD)
 20. Partia Balli Kombëtar” (PBK)
 21. Partia “Balli Kombëtar Demokrat” (PBKD)
 22. “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” (PBPPSH)
 23. “Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë” (PEISH)
 24. Partia “Rruga e Vërtetë Shqiptare” (PRVSH)
 25. Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European” (AMIE)
 26. Partia “Drejtësi Integrim dhe Unitet” (PDIU)
2. Partia udhëheqëse e Koalicionit është “Partia Demokratike” (PD), përfaqësuar nga Z. Sali Berisha.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI